



# Këshilli Konsultativ

Janar-Prill 2021



Zv.ministrja Kuko: “Këshilli Konsultativ, një histori sukcesi në dialogun midis qeverisjes qendrore dhe pushtetit vendor”

Fq.3

Mbledhja e Këshillit Konsultativ

## Miratojen projekt-aktet e para për vitin 2021

Vendorët: Të jemi pjesë e portalit "Mësues për Shqipërinë" Fq. 2

2020-a në shifra dhe fakte Fq. 6

Mblidhet Komiteti Drejtues i Asistencës Teknike Fq. 7

Historia e krijimit, 3 vjet Këshill Konsultativ! Fq. 10




Orlando Fusco: Qeverisja vendore, motori pozitiv i integritetit të Shqipërisë në BE!

Fq. 8



Aldrin Dalipi: Dialogu ndër-institucional forcon demokracinë vendore!

Fq. 5



Saimir Plaku: Këshilli Konsultativ, zëri i qeverisjes vendore

Fq. 6



Zana Vokopola: Një hap më shpejt drejt decentralizimit!

Fq. 9



## Miratohen projekt-aktet e para për vitin 2021

**“Startup-et”, masat e kompensimit dhe shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore si dhe disa shtesa në ligjin e transferimit të pyjeve të bashkitë, në fokus të diskutimeve.**



Mbledhja e parë e vitit 2021 për Këshillin Konsultativ solli një sërë projektaktesh për diskutim midis anëtarëve të tij, përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen prezantuan projektligjin “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, i cili parashikon lehtësira fiskale për një periudhë dy vjeçare. Shoqatat vendore nënvizuan nevojën për të rishikuar efektin financiar të këtij ligji që përcakton se si do të bëhet kompensimi financiar i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe përcaktimin e rolit të bashkive nëse ato mund të iniciojnë startup-e inovative bazuar në rregulloret e tyre.

Diskutimet vijuan me projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave," Për transferimin e pronësisë së bashkive të pyjeve publike dhe kullotave sipas listave të inventarit dhe aktualisht nën administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish-komunave/bashkive". Përfaqësuesit vendorë theksuan nevojën për të patur harta të qarta dhe të sakta të pronave që do të transferohen te bashkitë dhe se procesi i regjistrimit duhet të mbyllet brenda vitit.

Pas prezantimit të projektvendimeve për “Miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore” dhe “Përcaktimin e masës së

kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie” nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare për Emergjencat Civile, Haki Çako, u ra dakord që të merret parasysh kërkesa e bashkive për të përcaktuar një afat kohor brenda dy viteve.

Në mbledhje u miratuan edhe projektvendimi “Për përcaktimin e metodologjisë dhe kriterëve të llogaritjes së kuotës BID” dhe udhëzimi “Për miratimin e marrëveshjes operacionale TIP”, projektvendimi “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve, që nuk synohen për t’u konsumuar nga njeriu” dhe projektvendimi “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”.

Në këtë mbledhje u prezantua edhe kreu i ri i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), e cila luan rolin e Sekretariatit Teknik për Këshillin. Drejtori i ri, z. Saimir Plaku, pasoi në detyrë z. Bekim Murati.

I pranishëm në takim, z. Murati theksoi punën voluminoze që është bërë nga AMVV dhe Sekretariati për Këshillin Konsultativ në këto vite duke e shndërruar atë në një instrument të duhur për pushtetin vendor. “Diskutimet kanë qenë shumë të mira dhe puna goxha voluminoze. Mbetem besimplotë që ajo punë e mirë që është bërë deri tani do të vazhdojë dhe do të ngrihet në një nivel më të lartë”,- u shpreh Murati.

Duke vlerësuar arritjet e Këshillit Konsultativ, z. Plaku u shpreh se: “do ta shtyjmë përpara agjendën e decentralizimit dhe punën e nisur me Këshillin Konsultativ. Në drejtimin e Zv/ministres Kuko dhe asistencën e Delegacionit të BE-së, Këshilli do të arrijë të kthehet në një institucion të rëndësishëm për pushtetin vendor”.

“Mirënjohëse për punën e palodhur në drejtimin e Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore nga Drejtor Bekim Murati. Bashkë ishim një ekip frymëzues që shtymë përpara procesin e decentralizimit dhe jemi krenarë për rezultatet e arritura me bashkitë, Këshillin Konsultativ, Grupin Tematik të Decentralizimit.

Suksese në detyrë Drejtorit të ri të Agjencisë, Z. Saimir Plaku, i cili me përvojën, përkushtimin dhe vizionin e tij do të shtyjë përpara punën e bërë deri tani,”- është shprehur më herët zv.ministria e Brendshme dhe bashkëkryetarja e Këshillit Konsultativ, znj. Romina Kuko.



### Mbledhje të hapura online

Për shkak të pandemisë edhe mbledhje e muajit Shkurt u zhvillua online, në platformën Zoom në përputhje të plotë me rregullat anti-covid. Ajo u transmetua drejtpërsëdrejt në faqet e Këshillit Konsultativ dhe të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në Facebook.

### Propozimi i Vendorëve

## Bashkitë, pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”



Këshilli Konsultativ është një forum ku përfaqësuesit e pushtetit vendor bëjnë jo vetëm komentet, vërejtjet apo sugjerimet për projekt-aktet e qeverisë, por edhe për të sjellë propozimet e tyre në lidhje me pushtetin vendor. Gjatë takimit të muajit shkurt, znj. Adelina Farrici, drejtoresha ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore theksoi legjitimitetin i bashkive për të qenë pjesë e procesit të Portalit "Mësuesit për Shqipërinë". Ajo nënvizoi se brenda kornizës së autonomisë vendore dhe parimit të ushtrimit të funksionit të tyre, bashkitë duhet të përfshihen në procedurën e rekrutimit të mësuesve parashkollorë, nga identifikimi i një vendi të lirë pune, duke vendosur kritere shtesë për shpalljen e rezultatit të provimit të portalit "Mësues për Shqipërinë".





## Këshilli Konsultativ, një histori sukcesi në dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe pushtetit vendor

*Këshilli Konsultativ në optikën e zv.ministres së Brendshme dhe bashkëkryetares, Romina Kuko. Roli në procesin e decentralizimit, ecuria në vite dhe sfidat e të ardhmes.*

***Këshilli Konsultativ në krijimin e tij është vlerësuar nga faktori ndërkombëtar si një hap shumë i rëndësishëm në procesin e decentralizimit dhe të integritit të vendit. Si e shikoni ecurinë e Këshillit Konsultativ?***

Procesi i decentralizimit në Shqipëri ka kaluar në disa etapa thelbësore, më e fundit e të cilave është ajo e vitit 2014, ku, në bazë të ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", territori u nda në 61 njësi bazë të qeverisjes vendore nga 373 që ishin më parë. Riorganizimi i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) me qëllim eliminimin e fragmentarizimit të panevojshëm u shoqërua me një strategji decentralizimi shumëdimensionale dhe gjithëpërfshirëse dhe delegimin e funksioneve të reja te pushteti vendor nëpërmjet ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Të gjitha këto iniciativa kërkonin medoemos struktura mbështetëse për t'i shtyrë përpara dhe në këtë kuadër u krijua Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, e

cila më vonë u transformua në Agjencinë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore dhe si pjesë integrale e saj Këshilli Konsultativ, i cili ka shërbyer si një urë ndërlidhëse mes pushtetit qendror dhe vendor.

Përsa i përket rolit të tij, vlen të theksohet që ka qenë një nga instrumentat më të rëndësishëm në një dakordësim të gjerë mes dy pushteteve dhe kjo mund të vihet re qartë në numrin gjithmonë në rritje të mbledhjeve që ka patur si dhe të numrit të projekt-akteve dhe dokumenteve strategjike kombëtarë dhe ndërsektorialë që kanë kaluar përmes tij.

Gjithsesi, vlen të theksohet që pavarësisht progresit të konsiderueshëm që është bërë, decentralizimi është një proces që kërkon kohë dhe iniciativa të vazhdueshme. Si rrjedhim Këshilli Konsultativ, veç të tjerash duhet të intensifikojë iniciativa që dalin nga njësitë bazë apo grupe të tjera interesi dhe që kanë efekte gjithëpërfshirëse social-ekonomike te qytetarët në nivel vendor.



### **Mund të flasim për Këshillin Konsultativ si një histori suksesi?**

Mund të them me bindje se roli i Këshillit Konsultativ në procesin e decentralizimit në vend është i pazëvendësueshëm. Ai mendohet si një instrument kryesor për konsultimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave që kanë ndikim tek qeverisja vendore, si urë e domosdoshme për të mundësuar analizën e të gjitha instrumenteve ligjore apo dokumenteve strategjike sa më sipër përmendur. Gjatë viteve, roli i tij ka ardhur vazhdimisht në rritje duke u institucionalizuar si instrument i domosdoshëm për të dyja pushtetet, kështu kyç në procesin e decentralizimit dhe historitë suksesi.

Ka një konsensus të gjerë midis aktorëve të ndryshëm, pushtet qendror, pushtet vendor, partnerë zhvillimi, shoqëri civile, për përpjekjet serioze të Këshillit për të institucionalizuar konsultimin e çdo projekt-akti, politike apo strategjie që lidhet me pushtetin vendor, si forumi i pazëvendësueshëm, i cili vendos së bashku pushtetin vendor me atë qendror.

### **Cilat janë sfidat e afërta dhe të largëta të Këshillit Konsultativ?**

Aktualisht iniciativat e ardhura nga NJVV në Këshillin Konsultativ që prekin funksione specifike që ato kanë, janë shumë të pakta. Këshilli Konsultativ duhet të mendohet si një instrument i cili duhet jo vetëm të lehtësojë procedurat funksionale dhe organizative mes dy pushteteve, por në të njëjtën kohë duhet edhe të bashkërendojë dhe mbështesë iniciativat e bashkive që ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve të tyre. Për këtë qëllim roli i tij në të ardhmen duhet të jetë gjithnjë e më tepër dinamik në iniciimin e reformave dhe adresimin e problematikave ligjore të bashkive, ashtu edhe të koordinojë me ministrinë e linjës apo agjenci të tjetra në nivel qendror që në faza të hershme të ciklit politikbërës.

**Roli i tij në të ardhmen duhet të jetë gjithnjë e më tepër dinamik në iniciimin e reformave dhe adresimin e problematikave ligjore të bashkive.**

Gjithashtu, në periudhën afatshkurtër duhet të ndërmerren iniciativat të cilat rritin besimin dhe në të njëjtën kohë përdorimin e këtij Këshilli për çështje të lidhura me pushtetin vendor. Më konkretisht mendoj se sfidat afatshkurtra të Këshillit Konsultativ janë të lidhura me analizat e detajuara të efekteve social-ekonomike që sjellin projekt-aktet që kalojnë nëpërmjet tij në sektorët përkatës. Këto studime dhe analiza të detajuara janë thelbësore për të kuptuar jo vetëm pjesën e ndryshimeve të aprovuara, por në të njëjtën kohë për t'u ofruar bashkive informacione të detajuara mbi efektet afatmesme dhe afatgjata të ndryshimeve ligjore të diskutuara.

**Këshilli duhet të intensifikojë iniciativat që dalin nga njësitë bazë apo grupe të tjera interesi dhe që kanë efekte gjithëpërfshirëse socio-ekonomike te qytetarët.**

### **Këshilli po mbështetet nga BE nëpërmjet Projektit të Asistencës. Si e vlerësoni këtë projekt?**

BE është partneri strategjik ku Shqipëria synon të aderohet. Në këtë aspekt mbështetja e ofruar në kuadër të Këshillit Konsultativ është në të njëjtën linjë me rrugëtimin që Shqipëria ka. Për më tepër zhvillimi socio-ekonomik i vendit lejon dhe kërkon shërbime më cilësore pranë qytetarit. Pushteti vendor në Shqipëri me ligjin e vitit 2015 ka funksione në konsistencë të konsiderueshme me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore e si rrjedhim duhet të fuqizohet që t'i ofrojë këto funksione sa më mirë. Asistenca teknike e ofruar Këshillit Konsultativ jep pikërisht një mundësi që pushteti vendor të dëgjojë zërin e tij në instanca të ndryshme dhe në të njëjtën kohë në të gjitha strategjitë ndërsektoriale.

Intervistë me Kryetarin e Shoqatës së Këshillave të Qarqeve

## Dalipi: Dialogu ndërinstytucional forcon demokracinë vendore!

**Këshilli Konsultativ, si një mekanizëm në ndihmë të transparencës dhe konsultimit midis dy niveleve të qeverisjes. Inkurajimi i mëtejshëm i pushtetit vendor dhe përfaqësuesve të tij në funksion të forcimit të demokracisë vendore.**



“Këshilli Konsultativ është një mekanizëm që ndihmon fort transparencën dhe procesin e konsultimit të qeverisjes vendore me qeverisjen qendrore”, –thotë Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillit të Qarkut Tiranë dhe i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë. “Për të, dialogu që përfshin faktorët e qeverisjes vendore në dëgjimin e zërit të tyre në procesin e vendimmarrjes ndikon drejtpërdrejt në frymën e decentralizimit dhe forcimit të demokracisë vendore”. Si bashkëkryetar prej 3 vitesh, i Këshillit Konsultativ z. Dalipi e vlerëson bashkëdrejtimin me zv.ministren e Brendshme, Romina Kuko “të çmuar dhe produktiv, pasi roli i saj në avancimin e reformës për qeverisjen vendore ka qenë kurajoz”.

### **- Z. Dalipi si e vlerësoni përfshirjen dhe angazhimin e bashkive në mbledhjet e Këshillit Konsultativ?**

Janë tashmë tre vite angazhimi në Këshillin Konsultativ. Vetëm përgjatë vitit të kaluar janë paraqitur për diskutim një numër i lartë projekt-aktesh ligjore dhe mund të them që interesi ka qenë mbresëlënës në një drejtim me rolin motivues të shoqatave vendore përmes propozimeve të paraqitura. Po ashtu edhe grupe të tjera të interesit kanë qenë shumë aktivë në këtë platformë. Një risi kjo, pasi i ka shërbyer hapjes, transparencës dhe gjithë përfshirjes në Këshillin Konsultativ, shumë e rëndësishme për një vendimmarrje të konsoliduar. Aktivizimi i bashkive dhe qarqeve në mbledhjet e Këshillit Konsultativ siguron qëndrueshmërinë e bashkëpunimit të pushtetit qendror dhe atij lokal në të dyja nivelet. Politikën qendrore diskutohen për t'u përshtatur si çelësi me bravën drejt një vendimmarrje në interes të komuniteteve.

Mendoj që një element i rëndësishëm i diskutimeve në Këshillin Konsultativ është inkurajimi i pjesëmarrjes jo vetëm të kryetarëve të bashkive të përcaktuara si të mëdha për nga numri i popullsisë dhe territorit, por edhe të kryetarëve të bashkive që përfaqësojnë territore më të vogla. Një pikë kyçe është se po shkojmë drejt ekuilibrit të potencialeve që ka secila bashki. Pikërisht Këshilli Konsultativ ka nxjerrë në sipërfaqe nga diskutimet faktin që edhe bashkitë që

konsiderohen jo shumë të zhvilluara, të kërkojnë të kenë një tjetër këndvështrim për sa i përket çështjes së financave vendore, për sa kohë që në territorin e tyre kanë pasuri të çmuara me kontribut të ndjeshëm përmes taksave në nivelin qendror, siç është rasti i minierave apo pasuri të tjera natyrore.

Si rrjedhojë ka iniciativa të dobishme që qasja të ndryshojë në këtë raport dhe kohezioni në territor mes bashkive të nivelit të parë dhe atyre të nivelit të dytë, të zhvillohet edhe për faktin e përfitimit nga pasuritë kombëtare që ato kanë në territorin e tyre, në interes të përfitimit të cilësisë së shërbimeve nga ana e qytetarëve. Qarqet gjithashtu kanë pasur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, sepse kanë promovuar dhe integruar zërin e të gjithë faktorëve në territor.

### **- Si do ta vlerësonit punën e Këshillit Konsultativ?**

Pavarësisht situatës të cilën po kalojmë nga COVID-19, Këshilli Konsultativ nuk e ka ulur ritmin e tij, përkundrazi ka zhvilluar mbledhje online dhe gjithashtu ka patur një pjesëmarrje të kënaqshme të anëtarëve të ndryshëm në këtë platformë.

Këshilli Konsultativ është histori suksesi sepse ka arritur të bëjë që të dëgjohet zëri i qytetarëve përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në bashki këshillat bashkiakë dhe qarqet. Ndërkohë, vlen të përmendet në veçanti projekti i financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet Delegacionit të tij në Shqipëri, i cili konsiston në asistencën e Këshillit Konsultativ, duke sjellë kështu një mbështetje që forcon më tej rolin e Këshillit Konsultativ.

Në përfundim, mendoj që angazhimi serioz i të gjithë faktorëve të qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore, i shoqatave që advokojnë interesat e bashkive dhe qarqeve duhet inkurajuar dhe më tej në funksion të procesit të decentralizimit dhe të forcimit të demokracisë vendore.





## Këshilli Konsultativ, zëri i qeverisjes vendore

**Nga Saimir Plaku**

**Drejtor i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore**

Këshilli Konsultativ, një organ i ri në moshën institucionale, është një instrument tepër i rëndësishëm në procesin e harmonizimit të politikave qendrore me ato vendore dhe rajonale, për të rritur efikasitetin dhe transparencën në vendimmarrje e për të gjetur ekuilibrat e duhur në zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve. Fuqizimi i dialogut përmes proceseve politikbërëse, duke qenë gjithëpërfshirës dhe të hapur, ka ndikuar në

rolin e Këshillit për përgatitjen e kornizave legislative dhe zbatimin e politikave që nxisin histori të qëndrueshme suksesi, ofrojnë më shumë dialog dhe fuqizojnë aktorët në mbrojtje të interesave dhe të zhvillimit të komuniteteve lokale.

Në rrugëtimin e tij, Këshilli Konsultativ, si forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, ka luajtur një rol thelbësor për të institucionalizuar dhe rritur efektivitetin e konsultimit dhe ndërveprimit midis Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore. Ai u ka dhënë zë politikave të njëjësive vendore të qeverisjes dhe harmonizimit të tyre deri në vendimmarrje nga organet e qeverisjes qendrore ose Kuvendit. Ka hartuar e implementuar politika që prekin në mënyrë direkte interesat e komunitetit në njësitë lokale të qeverisjes dhe ka ofruar konsulencë dhe praktika më të mira në çështje me interes të lartë. Këshilli Konsultativ ka rritur nivelin e transparencës, llogaridhënies dhe konsultimeve, duke shërbyer dhe si një urë ndërlidhëse midis vetë institucioneve dhe raportit të tyre me qytetarët.

Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të Këshillit Konsultativ është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm dhe të denjë që bashkëpunojnë frytshëm me qeverisjen qendrore në fushat e tyre të përgjegjësisë.

### 2020-a në shifra dhe fakte

- Gjatë vitit 2020 në Këshillin Konsultativ janë paraqitur për diskutim gjithsej **37 projektakte** ligjore, nga të cilat **7 projektligje** dhe **30 projektvendime**.
- Mesatarisht **12 bashki** kanë qenë të pranishme në mbledhje, nga **11 bashki** sipas detyrimit ligjor.
- **9 bashki** kanë qenë të pranishme me përfaqësues Kryetarin e Bashkisë (81%). Pjesa tjetër me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike.
- Niveli i përfaqësimit në Këshill i qeverisjes vendore është relativisht i lartë përkundrejt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit.

Mbahet takimi i dytë i Komitetit Drejtues

## Arritjet dhe sfidat e Asistencës Teknike

**Diskutime të frytshme mbi mbështetjen teknike të ofruar në 6 muaj. Nevoja për të pasur mbështetje të mëtijshme dhe të qëndrueshme nga Delegacioni i BE-së për Këshillin Konsultativ.**



Më 23 mars 2021, Komiteti Drejtues i Projektit “Asistencë Teknike për Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore”, zhvilloi takimin e tij të dytë. Fokusi i takimit ishin rezultatet e arritura dhe niveli i zbatimit të projektit në gjashtëmujorin e tij të parë. Drejtuesi i ekipit të projektit, Drini Nushi bëri një pasqyrë të arritjeve dhe hapave të mëtijshëm që do të ndërmerren për të realizuar brenda afatit të gjitha objektivat e pikësnyuara. Rezultate të dukshme janë shënuar në përmirësimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ, ku është përgatitur Projektrregullorja e brendshme si dhe organizimi dhe funksionimi i Komiteteve të Përkohshme si një mekanizëm për të përjashtuar temat e rendit të ditës që kanë ndikim ose interes më të ulët për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Një tjetër detyrë e rëndësishme e projektit është rritja e rolit të bashkive nëpërmjet Këshillit Konsultativ. Në këtë drejtim disa nga arritjet që u përmendën ishin mbështetja e shoqatave vendore në Këshill, mbështetja e anëtarëve të Këshillit nga bashkive në mënyrë që opinionet dhe mendimet e tyre të merren parasysh nga ministrinë e linjës dhe disa prej tyre tashmë janë marrë parasysh, asistimi i bashkive me procedurat për mbështetjen e propozimeve të tyre.

Në takim u vlerësuan arritjet e deritanishme si dhe nevoja për të çuar në një nivel më të lartë asistencën legislative dhe sistemin e komunikimit. U theksua se megjithë kushtet e pafavorshme të një viti të vështirë për shkak të pandemisë, po punohet që të arrihet me cilësi çdo objektivi i synuar. Nga ana tjetër, nisur nga nevojat e Këshillit Konsultativ, u shtua se krijimi i një

asistence të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, do të jepte më shumë kontribut për fuqizimin e rolit të Këshillit si një forum zyrtar konsultimi midis qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore.

### Këshilli Konsultativ, me faqe zyrtare në rrjetet sociale

Projekti i asistencës vijon punën edhe në aspektin e komunikimit me qëllim rritjen e transparencës. Prej janarit 2021 Këshillin Konsultativ mund ta gjeni me faqet zyrtare edhe në median sociale; Facebook, Instagram dhe Twitter. Në faqen e Këshillit në Facebook mund të ndiqen drejtpërsëdrejt mbledhjet e Këshillit të cilat nga fillimi i pandemisë, zhvillohen online në përputhje me rregullat e vendosura nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.







## Qeverisja vendore, motori pozitiv i integrimit të Shqipërisë në BE!

**Nga Orlando Fusco**

**Officer Programi për Qeverisjen e Mirë në Delegacionin e BE-së**

Si një vend në zhvillim, Shqipëria, vijon përpjekjet për të ecur drejt mirëqenies dhe ekonomisë së qëndrueshme, por mbi të gjitha për të finalizuar procesin e integrimit në Bashkimin Evropian. Sfidat e këtij rrugëtimi janë të shumta dhe kanë fokus sprovimin e vendit drejt standardeve evropiane dhe po aq të shumta janë përfitimet që vijnë, në interes të të gjithë qytetarëve. Në këtë kuadër Delegacioni i Bashkimit Evropian është mbështetësi dhe udhërrëfyesi për të vijuar reformat e nisura të cilat shtrihen në të gjitha nivelet e qeverisjes së vendit. Pikërisht, pushteti vendor ka një rol kyç në arritjen e këtij objekti strategjik të Shqipërisë. Ndaj, për të çuar

më para agjendën e decentralizimit dhe kontributin e qeverisjes vendore në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE, Delegacioni i Bashkimit Evropian po mbështet përmes Institutit të Kërkimeve Urbane (URI) dialogun institucional midis qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore në Këshillin Konsultativ.

Projekti “Asistencë teknike për Këshillin Konsultativ” është pjesë e një portofoli në rritje të ndihmës nga BE për qeverisjen vendore në Shqipëri. Dialogu ndërinstytucional dhe bashkëpunimi midis qeverisë vendore dhe asaj qendrore çon përpara zbatimin e agjendës së decentralizimit dhe forcon demokracinë vendore. Ai përmirëson pikërisht atë që Komisioni Evropian e ka theksuar në raportin e tij vitit 2020 për Shqipërinë, sipas të cilit Këshilli Konsultativ ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Por ka ende punë për të bërë që qeveria vendore dhe shoqatat që e përfaqësojnë atë, të konsultohen në mënyrë më efektive dhe të mund të sjellin pozicione të konsoliduara në tryezë.

Mbi 70 për qind e legjisllacionit të BE-së zbatohet në nivelin vendor dhe pikërisht për këtë arsye përfshirja e autoriteteve vendore dhe komuniteteve është thelbësore. Ato mund të përcaktohen si motorët pozitivë të integrimit të vendit në BE.

Duhet kuptuar qartë se përfitimet e integrimit në BE kanë të bëjnë me shërbime më të mira, standarde më të mira, më shumë fonde dhe programe në shumë sektorë, duke u bërë një mbështetje e fortë dhe e qëndrueshme për Shqipërinë. Integrimi i vendit duhet parë si një mundësi për të përmirësuar jetën e qytetarëve kudo në vend. Janë ata që duhet të korrin përfitimet që vijnë nga mundësitë që Bashkimi Evropian i ofron çdo qytetari gjithnjë e më shumë ndërsa vendi i afrohet anëtarësimin.

## Çfarë është Projekti i Asistencës?



“Asistencë Teknike për Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore” është projekti që po asiston Këshillin Konsultativ prej shtatorit të vitit 2020. Projekti i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë është një kontribut të çmuar për çuarjen përpara të procesit të decentralizimit në Shqipëri. Ndër rezultatet e pritshme të këtij projekti përmendim: përmirësimin e organizimit dhe menaxhimit i Këshillit, rritjen e rolit të pushtetit vendor në vendimmarrje, fuqizimin e kapaciteteve të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore e cila luan rolin e Sekretariatit Teknik, në menaxhimin dhe aktivitetet e Këshillit si dhe rritjen e kapaciteteve në lidhje me kuadrin ligjor dhe buxhetin vendor në përputhje me standardet e BE-së. Projekti i Asistencës po zbatohet nga Instituti i Kërkimeve Urbane, i cili do të mbështesë Këshillin Konsultativ deri në fund të gushtit 2021.



## Një hap më shpejt drejt decentralizimit

**Nga Zana Vokopola**  
**Drejtoresh Ekzekutive e Institutit të Kërkimeve Urbane**

Vendi ynë qeveriset në dy nivele, atë qendror dhe atë vendor; kryetarët e qeverisjes qendrore zgjidhen nga qytetarët, dhe kryetarët e qeverisjes vendore zgjidhen gjithashtu nga qytetarët. Mbi këtë bazë kushtetuese, marrëdhënia ndërmjet institucioneve të të dy niveleve të qeverisjes së vendit është rregulluar me ligj si një marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta; institucionet e qeverisë qendrore konsultohen me ato të njësisë të qeverisjes vendore për projekt-politika dhe ligje të cilat rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre të fundit, ndërkohë që për shumë nga këto funksione, veçanërisht për shërbimet publike, të dy nivelet e qeverisjes ndajnë kompetenca e përgjegjësi. Kështu, procesi i konsultimit ndërmjet tyre është i një rëndësie të veçantë për qeverisjen e mirë të vendit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që përfitojmë si qytetarë.

Ekspertët e Institutit të Kërkimeve Urbane kanë qenë mbështetësit e parë të vendosjes së kësaj marrëdhënieje konsultimi dhe bashkëpunimi mes të dy niveleve të qeverisjes në vendin tonë, duke propozuar dhe hartuar ndryshimin e nevojshëm në ligjin për vetëqeverisjen vendore të periudhës para Reformës Administrative e Territoriale, ndryshim i cili është dhe sot pjesë e ligjit të ri në fuqi. Ata vijuan me propozimin e organizimit dhe funksionimit të kësaj marrëdhënieje ndërmjet një këshilli i cili do të mblidhte në një tryezë të përbashkët, me një program pune, kryetarët e të dy qeverive. Këshilli Konsultativ mes qeverisë qendrore dhe vendore që vepron sot u

ngrit në vitin 2017 mbi bazën e këtyre propozimeve, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit të vendit.

Në muajin shtator 2020, me mbështetjen financiare të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Instituti i Kërkimeve Urbane mori përsipër përmirësimin e mëtejshëm të formës së organizimit dhe funksionimit të Këshillit dhe të kapaciteteve njerëzore të anëtarëve dhe aktorëve të tij. Si rezultat i punës së gjashtë muajve të parë, Këshilli ka një plan të veprimtarisë vjetore të tij, i cili është i harmonizuar me planin e institucioneve të qeverisjes qendrore, ka një rregullore tërë të brendshme e cila rregullon më hollësisht veprimtarinë e Këshillit dhe e zgjeron atë nga marrja në diskutim e një projekt-akti ligjor deri në vendimmarrjen e argumentuar të institucioneve të qeverisë qendrore në lidhje me të; gjithashtu, ka një procedurë standarde për analizën e projekt-akteve të propozuara dhe përgatitjen në kohë të argumenteve dhe pozicioneve nga institucionet e të dy niveleve të qeverisjes, të cilat diskutohen më pas në tryezën e përbashkët të Këshillit.

Në vëmendje të veçantë të kësaj mbështetjeje teknike është përmirësimi i komunikimit të Këshillit me anëtarët dhe aktorët e tij; për këtë, janë hartuar një tërësi mjetesh komunikimi si materiale grafike, media sociale, njoftime në shtyp, si dhe ky buletin, i cili botohet për herë të parë.

**Procesi i konsultimit është i një rëndësie të veçantë për qeverisjen e mirë të vendit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që përfitojmë si qytetarë.**

”

Mbështetja teknike do të vazhdojë dhe në muajt në vijim, duke u përqendruar në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të anëtarëve dhe aktorëve të Këshillit dhe ngritjen e një platforme të dedikuar për komunikimin e anëtarëve dhe aktorëve të tij. Qëllimi përfundimtar i saj është të mbështesë transformimin gradual të tij në një institucion me kapacitetet e duhura për të sjellë përparimin e decentralizimit të qeverisjes, por edhe për të propozuar dhe nxitur zgjidhje për çdo çështje të ngritur nga institucionet e qeverisë vendore.



Historia e krijimit të tij, parimet e konsultimit dhe arritjet

## 3 vjet Këshill Konsultativ!

***Ngritja e këtij institucioni krijoi kushtet për një realitet të ri të bashkëpunimit dhe forcimit të dialogut midis të dy niveleve të pushtetit, për të shkëmbyer dhe diskutuar politikën, ligjet apo nismat me ndikim të drejtpërdrejtë të qeverisja dhe komunitetet vendore.***



Këshilli Konsultativ është forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit midis dy niveleve të qeverisjes. Krijimi i tij u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave, më 21 dhjetor 2016. Me këtë vendim, për herë të parë në Shqipëri, qeverisja qendrore do të niste konsultimin e institucionalizuar me përfaqësues të vetëqeverisjes vendore në lidhje me decentralizimin, financat vendore dhe funksionet e bashkive.

Një muaj më pas, në 19 janar 2017 do të mbahej ceremonia e përirimit të Këshillit Konsultativ me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Andreas Kiefer, të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, Drejtores së USAID për Shqipërinë, Cate Johnson, ambasadorit zviceran në Shqipëri, Christoph Graf dhe përfaqësuesve të shoqatave vendore e kryetarë bashkish e qarqesh.

Krijimi i Këshillit Konsultativ ishte një zbatim i drejtpërdrejtë i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje. Në fillimet e tij ai u mbështet nga Këshilli i Evropës, Qeveria e Zvicrës dhe USAID i cili nëpërmjet projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore ka ofruar mbështetje teknike, logjistike dhe financiare për Këshillin Konsultativ duke dhënë kontribut në shndërrimin e tij në një institucion të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në procesin e hartimit të ligjeve në vend. Prej shtatorit 2020 Këshilli po mbështetet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Ngritja e Këshillit Konsultativ krijoi kushtet për një realitet të ri të bashkëpunimit dhe forcimit të dialogut midis të dy niveleve të pushtetit, për të shkëmbyer dhe diskutuar politikën, ligjet apo nismat me ndikim të drejtpërdrejtë të qeverisja dhe komunitetet vendore.

## Disa arritje ndër vite

Sipas një raporti të përgatitur nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore e cila luan rolin e Sekretariatit Teknik për Këshillin, nga mbledhja e parë e vitit 2017 deri në fund të vitit 2019, Këshilli Konsultativ ka arritur që të institucionalizojë procesin e konsultimit midis dy niveleve të qeverisjes, duke informuar të gjithë palët për projektvendimet, projektligjet dhe projektstrategjitë që propozohen nga Qeverisja Qendrore.

Është realizuar mbledhja e vërejtjeve, mendimeve, komenteve dhe propozimeve të bashkive dhe iu është bashkëlidhur praktikës dokumentuese që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.

Nga konsultimet në Këshill, ka pasur raste kur projekt-aktet janë kthyer për t'u riparë për shkak të vërejtjeve dhe sugjerimeve nga pushteti vendor, si rasti i Projektvendimit "Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit". Vijimi i procedurës për miratimin e këtij projektvendimi u bllokua deri në rishikimin e plotë të projektvendimit. Ndërkohë janë miratuar projektvendime që prekin funksionet dhe interesat e bashkive.

Janë njohur paraprakisht Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me masat që duhet të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Ligjeve dhe VKM-ve dhe është rritur transparenca duke përfshirë shoqatat e bashkitë në procesin e formulimit të projekt-akteve ose projektligjeve.

## 4 PARIMET E PROCESIT TË KONSULTIMIT:

**Informimi**  
**Këshillimi**  
**Angazhimi**  
**Bashkëpunimi**

**INFORMIMI** i njësive të vetëqeverisjes vendore për projektligjet e propozuara nga qeverisja qendrore

**KËSHILLIMI** mendime, komente, vërejtje, propozime midis 2 niveleve të qeverisjes

**ANGAZHIMI** përfshirja e shoqatave dhe vetëqeverisjes vendore në procesin e formulimit e miratimit të projektakteve & zgjidhjeve konkrete

**BASHKËPUNIMI** dhe dialogu konstruktiv me shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.





## *Këshilli Konsultativ Janar-Prill 2021*

---

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Institutit të Kërkimeve Urbane dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian